



PROMOVIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK NËPËRMJET SHOQËRISË CIVILE
– FAZA E DYTË -

RAPORTI HULUMTUES LIDHUR ME ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL

Dhjetor 2003

I. Hyrje

Ky raport përmban vlerësimet mbi proceset në zhvillimin ekonomik lokal në Kosovë dhe është përgatitur në kuadër të projektit "Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shqërsisë Civile" – faza e dytë, mbështetur nga USAID.

Raporti ka për qëllim të bëjë vlerësimin masave dhe të aktiviteteve të ndërmarra në realizimin pas mbajtjes së sesionit V të Tryezës së Forumit Ndërkombëtar (16 Prill 2002). Ai jep një paqyrë të zhvillimeve sidomos lidhur me realizimin e rekomandimeve nga kjo tryezë. Përpos kësaj, raporti synon që të bëjë aktualizimin e rekomandimeve sipas nevojës, karshi gjendjes aktuale në zhvillimin ekonomik lokal.

Në mënyrë më specifike raporti trajton këto çështje:

- Konsolidimi i pushtetit komunal,
- Zhvillimi ekonomik,
- Politika tatimore, dhe
- Shërbimet publike.

Ky Raport është bazuar në vizitat në terren të stafit të Riinvestit, në raportet hulumtuese të Riinvestit, dhe në raporte hulumtuese të institucioneve të tjera. Ekipi i Riinvestit ka zhvilluar biseda punuese në Ministrinë e Shërbimeve Publike, me Kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, në Kuvendin Komunal të Gjilanit, në Qeveritë Komunale të Prishtinës, të Malishevës dhe të Shtimjes. Janë shfrytëzuar materialet dhe publikimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe materialet dhe publikimet e institucioneve dhe organeve të tjera vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me problematikën e pushtetit lokal dhe zhvillimin ekonomik lokal. Vecmas janë shfrytëzuar:

Riinvest (2002): Tryeza e Forumit Ndërkombëtar lidhur me Zhvillimi Ekonomik Lokal në Kosovë, Prishtinë, 2002.

Riinvest (2002): Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë, Raporti Vjetor, Prishtinë, 2002.

Riinvest (2003): Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm, Prishtinë, 2003.

UNDP (2003): Mozaiku i Kosovës - Përceptimi për Qeveritë Komunale dhe Shërbimet Publike në Kosovë, Prishtinë, 2003.

MEF (2003): Projekti i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2004;

MEF (2003) Aktualitetet Fiskale dhe raporti i analizave të rrjedhave ekonomike, shtator 2003.

I. Tryeza e Pestë e Forumit Ndërkombëtar

Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest në kuadër të realizimit të projektit “Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile “ – faza e parë, më 16 Prill 2002, e trajtoi në Tryezën e Pestë të Forumit Ndërkombëtar Raportin hulumtues lidhur me zhvillimin ekonomik lokal. Raporti kishte për qëllim prezentimin e problemeve aktuale të zhvillimit ekonomik lokal në Kosovë dhe propozimin e rekomandimeve mbi aktivitetet prioritare të nevojshme për ndërtimin e rolit të pushtetit lokal në zhvillimin ekonomik në pajtim me kërkesat e ekonomisë së tregut.

Cilat ishin objektivat themelore nga Tryeza e Pestë e Forumit Ndërkombëtar mbi zhvillimin ekonomik lokal?

- integrimi i zhvillimit ekonomik dhe social dhe i aktiviteteve ekonomike me rrethinën, të cilat do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë së jetës në lokalitete;
- mbështetja e bizneseve lokale, nëpërmjet rritjes së investimeve atraktive;
- nxitja e përdorimit optimal të resurseve në nivele lokalitetesh dhe në nivel të vendit në tërësi;
- promovimi i bizneseve të vogla dhe të mesme lokale dhe i kulturës së ndërmarrësisë;
- rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike të pushtetit lokal;
- ndërtimii i koalicioneve për zhvillim të suksesshëm lokal dhe partneritetit midis sektorit publik, sektorit privat dhe OJQ-ve në të mirë të zhvillimit lokal;
- stimulimi i diskutimit dhe dialogut të të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces për avancimin e çështjes dhe aktiviteteve ndaj zhvillimit ekonomik lokal.

Në fokus të shqyrtimeve ishin problemet e organizimit të pushtetit lokal në Kosovë të bazuara në Rregulloren 2000/45 të UNMIKut mbi “Vetëqeverisjen Komunale në Kosovë”, roli i pushtetit lokal, sfidat në ndërtimin e kapaciteteve në administratën komunale, ndarja e pushtetit midis nivelit qendror dhe atij lokal, problematika e shërbimeve publike komunale, mbrojtja e ambientit dhe resurset njerëzore dhe formimi i koalicioneve dhe rrjeteve të partneritetit. Rekomandimet e tryezës ishin të fokusuara në krijimin e një sinergjie të të gjithë akterëve të zhvillimit ekonomik lokal; në rregullimin e aspekteve të procesit buxhetor, të legjislacionit, transferit të më shumë kompetencave në administratën lokale, përmirësimin e shërbimeve publike, zhvillimin e kapaciteteve të qeverive lokale, reduktimin e shpenzimeve dhe ndërtimin e partneritetit, i cili shpie kah zhvillimi i një strategjie të qëndrueshme të Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Instituti Riinvest gjatë kësaj periudhe ka përcjellur rrjedhat në zbatimin e rekomandimeve dhe në avancimin e botëkuptimit mbi një zhvillim modern ekonomik lokal. Në mënyrë të veçantë është angazhuar në advokimin e rekomandimeve në fushën e tatimeve dhe të

ngarkesave tjera fiskale lokale në mënyrë që ato të jenë të përballueshme për bizneset dhe tatimpaguesit tjerë. Ne periudhen Janar 2002 – Maj 2003 Riinvesti ka qenë i ankgazhuar në realizimin e programit DELTA (deri më tani në shtatë komuna). Ky projekt kishte për qëllim ndërtimin e kapaciteteve nëpër komuna për zhvillimin e NVMve dhe gjithashtu për hartimin dhe sendërtimin e strategjive dhe politikave të zhvillimit ekonomik lokal. Në kontaktet me udhëheqësit e komunave dhe specialistët e shërbimeve të caktuara të cilat ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, si dhe me institucionet financiare, ato qeveritare dhe komunitetin e biznesit, Instituti në mënyrë aktive ka advokuar rekomandimet tjera nga Tryeza e Pestë e Forumit Ndërkombëtar.

(Rekomandimet te shihen edhe njeher se a jane keto me te rendesishme ?)

Pjesë nga rekomandimet e Tryezës së Pestë të Forumit Ndërkombëtar mbi Zhvillimin Ekonomik Lokal.

- Kërkohej përpjekje e bashkërenditur e qeverive lokale, bizneseve private, komunitetit të donatorëve dhe shoqërisë civile, me qëllim të zhvillimit të një strategjie të fortë të ZHELit.
- Zhvillimi i një legjislacioni, i cili rregullon të gjitha aspektet e procesit buxhetor për Qeverinë e Kosovës dhe komunat, i cili do të specifikonte në mënyrë të qartë rolin dhe përgjegjësitë e të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces;
- Të bëhet progres në transferin e më shumë kompetencave administratës lokale dhe të përmirësohet niveli i organizimit të komunave;
- Të bëhet në mënyrë urgjente përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike komunale përmes definimit të përgjegjësiave adekuate të komunave në menaxhimimin e shërbimeve publike dhe komunale, rritjes së kapaciteteve menaxheriale të administratës komunale dhe përmirësimit të sistemit të vjeljes së detyimeve për shërbimet që u ofrohen qytetarëve;
- Të zhvillohen kapacitetet e qeverive lokale për promovimin e ZHELit përmes ofrimit të një ambienti miqësor për NVMtë, promovimin e prodhimeve dhe shërbimeve vendore, përmirësimin e sistemit të këmbimit të informacioneve, përmirësimin e procedurave dhe aplikimin e lehtësive për regjistrimin e bizneseve, etj.

II. KONSOLIDIMI I PUSHTETIT LOKAL

2.2. Bartja e kompetencave nga UNMIKu

Në përgjithësi komunat Kosovare kanë bërë një përparim të dukshëm në konsolidimin e pushtetit lokal, e sidomos pas zgjedhjeve të dyta lokale, ato kanë krijuar një përvojë të caktuar që u mundëson të merren me problemet reale. Në nivelin e pushtetit komunal akoma ekziston një prani ndërkombëtare, e cila përkujdeset për respektimin e ligjshmërisë së institucioneve të zgjedhura komunale nga vota e popullit. Administratori komunal ndërkombëtar i cili kishte pothuajse fuqinë themelore në pushtetin lokal tani është zëvendësuar me përfaqësuesin e UNMIKut që ka një rol këshilldhënës. Hapja e

zyreve pritëse nëpër disa komuna Kosovare, të cilat i orientojnë qytetarët se ku mund t'u ofrohen shërbime të ndryshme komunale, është një hap i mirë drejt ofrimit të shërbimeve më të mira qytetarëve. Prandaj, si i tillë, ky hap duhet të ndiqet nga të gjitha komunat në Kosovë. Në një numër të vogël të komunave ka filluar edhe realizimi i projekteve për themelimin e zyreve për shërbime të shpejta, për nevoja të bizneseve.

Edhe pse komunat sipas Rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave kanë mandatin të qeverisin me çështjet lokale, ekzistojnë rregullore¹ të tjera të miratuara nga pushteti qendror, të cilat konfliktuojnë me këtë rregullore dhe rrjedhimisht paraqesin një hendikep për komunat në ushtrimin e autoritetit të tyre. Prandaj, është kërkesë e zyrtarëve komunalë që të miratohet një ligj i veçantë për komunat me të cilat do të qartësoheshin dhe saktësoheshin cilat janë kompetencat e pushtetit lokal dhe cilat janë kompetencat e pushtetit qendror. Edhe pse kjo ka qenë njëra ndër çështjet më të apostrofuara në Sesionin V dhe shumë herë në raste të tjera, nuk është arritur ende një progres i vlefshëm për evitimin e ambiguiteteve dhe paqartësive lidhur me kompetencat dhe ndarjen e pushtetit në nivelin qendror dhe lokal si dhe në raportet me administratën ndërkombëtare. Ka mbetur ende gjendja e njëjtë me shërbimet publike, ndërsa është ashpërsuar konflikti lidhur me menaxhimin e pronës shoqërore/komunale sidomos me AKMnë.

2.2. Bashkëpunimi me nivelin qendror dhe problemet eventuale në ndarjen e kompetencave

Bashkëpunimi i të dy niveleve të pushtetit – atij lokal dhe atij qendror, është akoma në nivel jo të kënaqshëm. Kjo për shkak se të drejtat dhe obligimet të cilat i ka komuna sipas Rregullores 2000/45 nuk mund të materializohen si duhet për shkak të përzierjes së kompetencave në mes të dy pushteteve. Si rezultat i kësaj, ekziston një konfuzion lidhur me përgjegjësitë konkrete të niveleve të ndryshme të pushtetit. Për të patur një qeverisje të mirë duhet të ndahen qartazi rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve qendrore e lokale, por në këtë rrafsh edhe vetë qytetarët por edhe zyrtarët komunalë duhet t'i kuptojnë mirë ato. Vetëm kështu, mund edhe të kërkohej përgjegjësia e institucioneve.

Një çështje brengosëse është ajo e regjistrimit civil - kërkesa që u bëhet qytetarëve të Kosovës nga zyrat për regjistrim civil (të cilat janë të udhëhequra nga zyrtarë ndërkombëtarë) për të dokumentuar identitetin e vet me dokumente të regjimit Sërb. Kjo është e panevojshme dhe joligjore kur dihet se njëherë qytetarët Kosovarë veç janë regjistruar dhe ata tani posedojnë letërnjoftimet e UNMIKut. Kërkesa që iu bëhet qytetarëve Kosovarë për dokumente të regjimit Sërb gjithashtu është edhe në kundërshtim me rendin që sot është krijuar në Kosovë.

Sipas opinionit të zyrtarëve komunal, niveli qendror duhet ta kuptojë se qeveritë lokale nuk janë të deleguara nga pushteti qendror, por ato i japin llogari të drejtpërdrejtë elektoratit që i ka zgjedhur.

¹ Rregullorja 2000/49 mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Shërbimeve Komunale Publike; Rregullorja 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji 2002/19 mbi Arsimin Parësor dhe Dytësor.

2.3. Menaxhimi i pronës komunale dhe relacionet me AKMnë

E drejta e marrur nga AKM që të menaxhojë me pronën komunale ka shkaktuar konflikt të interesave me komunat. Si rrjedhojë e pamundësisë së menaxhimit me pronën komunale, komunat nuk janë në gjendje t'u ofrojnë mbështetje dhe kushte më të mira për afarizëm bizneseve. Vonesat e shkaktuara nga shqyrtimet e rasteve nga AKM për lejimin e përdorimit të tokës komunale për fillimin e projekteve të ndryshme janë të paarsyeshme dhe shpeshherë çojnë në humbjen e shanseve investive.

Rasti i Malishevës:

Për t'u përmendur është shembulli në Komunën e Malishevës, ku një ndër ndërmarrësit më të sukseshëm në Slloveni me prejardhje nga Malisheva, ka bërë projektin për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e pajisjeve elektrike. Sipas zyrtarëve komunalë të Malishevës, ky është një ndër projektet me serioze në komunë. Sipas tyre, kjo ndërmarrje e ka të siguar tregun në Ballkan si dhe në fillim do të punësonte rreth 250 punëtorë. Qeveria komunale e Malishevës ka vendosur që t'ia jap në shfrytëzim pa pagesë tokën komunale kësaj ndërmarrjeje, por sipas zyrtarëve kjo gjë është bllokuar nga AKM.

2.4. Gjëndja e stafit komunal

Nëpër komunat Kosovare është punuar mjaft në përgatitjen e stafit për kryerjen e detyrave ekzistuese, por edhe për marrjen e detyrave të reja. Deri më tani 24 komuna Kosovare janë çertifikuar për menaxhimin me tarifa dhe ngarkesa, kurse 29 komuna janë çertifikuar për menaxhim të financave. Megjithatë ekziston një bindje e përgjithshme që duhet të ekzistojë një politikë konstante rreth menaxhimit me resurset humane - për trajnimin dhe ritrajnimin e stafit të administratës, e sidomos në fushën e teknologjisë informative.

Komunat gjithashtu, kanë nevojë për freskimin gradual të stafit me kuadro të reja si dhe për racionalizimin e vendeve të punës. Përpjekjet për riorganizimin e stafit komunal nuk duhet të bazohen sipas përkatësisë politike dhe partiake, por edhe tendencat qëllimmira për bërjen e kësaj me qëllim të rritjes së efikasitetit të administratës komunale nuk duhen të keqinterpretohen nga faktorë të ndryshëm politik nëpër komuna.

2.5. Vlerësimi i nevojave për decentralizim

Misioni për decentralizim i Këshillit të Evropës, pas një pune të bërë gati njëvjeçare në Kosovë, në projektin e tij për decentralizim shpreh se synimi kryesor i kësaj reforme është që të bëjë bartjen e proceseve vendimmarrëse sa më afër qytetarëve dhe popullatës së Kosovës t'u sigurohen shërbime publike më të mira dhe administratë publike më efikase, duke nënvizuar se ai bazohet kryesisht në parimin e përplotësimit (subsidiaritetit) dhe kritereve të Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Sipas kësaj, viti 2006 shihet si moment kyç, kur edhe do të mbaheshin zgjedhjet për njësitë nënkomunale, krahas atyre

për njësitë komunale, ndërsa para kësaj do të bëheshin përgatitjet e zyrave dhe të stafit. Duke pohuar se reforma është përgatitur në bazë të kriterëve gjeografike dhe demografike dhe jo mbi ato etnike, për çka kishte vërejtje të shumta në komunat e Kosovës, Misioni u përcaktua se duhet të krijohen afër 180 njësi nënkomunale, me numër mesatar prej rreth 5000 qytetarëve për një njësi nënkomunale (në zonat e largëta së paku 1000, kurse në zonat me popullatë të dendur mund të arrijë deri në 15,000 qytetarë). Ky projekt parasheh edhe krijimin e njësive nënkomunale në shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës. Parashihet se komunat ekzistuese do të mbeten elementi kryesor i vetëqeverisjes lokale, me përkufizimin e qartë të raportit të tyre me nivelin qendror dhe nënkomunal. Përgjegjësitë e njësive nënkomunale, sipas këtij projekti sillen nga inkasimi i disa të hyrave lokale, manaxhimi i pronave publike lokale, kompetencave në arsimin parashkollor dhe fillor, në infrastrukturë dhe në shërbime publike. Në funksion të realizimit të kësaj reforme, parashihet ndërërmarrja e disa masave paralele, të cilat konsistojnë në sqarimin e çështjeve të pronës publike dhe në hartimin e disa ligjeve, ndër të cilat: Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Zgjedhjet, Ligjin për Tatimet dhe Taksat Lokale dhe Pagesat etj.

2.6. Kostoja dhe implikimet e decentralizimit

Nga hartuesit e këtij projekti parashihet se kostoja fillestare e investimeve të jetë së paku €7,230,000, ndërsa kostoja operationale e administratës lokale dhe e vetëqeverisjes lokale pas reformës, për shkak të rrogave të stafit të shtuar dhe të shpenzimeve të përgjithshme në njësitë nënkomunale, do të jetë përafërsisht 10-15 për qind më e lartë se kostot e tanishme. Këshilli i Evropës parashikon se duhet të punësohen rreth 660 nëpunës të rinj për njësitë nënkomunale dhe afër 1100 nëpunës komunalë duhet të zhvendosen në njësitë nënkomunale.

Duke akceptuar nevojën e bartjes të proceseve vendimmarrëse si dhe të shërbimeve sa më afër qytetarëve dhe të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të tyre, zyrtarët komunal, të Asociacionit të Komunave të Kosovës, si dhe atë të organeve të përkohshme qendrore të vetëqeverisëse të Kosovës janë shprehur që ky proces nuk duhet të bazohet në parime etnike, ndërsa kanë vlerësuar se dokumenti i ofruar nga Misioni për Decentralizim i Këshillit të Evropës duhet të studiohet dhe të vlerësohet.

Edhe decentralizimi fiskal shikohet si një mjet i rëndësishëm për ta arritur pjesëmarrjen demokratike në procesin e vendim-marrjes dhe në këtë mënyrë për rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës buxhetore. Ai duhet t'i përgjigjet ruajtjes së tërësisë së politikave makroekonomike, nivelit zhvillimor dhe eficiencës, përkatësisht koston së tij. Është e qartë se shkalla e transferit të shpenzimeve dhe përgjegjësi për gjenerimin e të hyrave kanë implikime të dukshme në aftësinë e pushtetit qendror për t'i realizuar politikat makroekonomike nëpërmjet buxhetit. Humbja e instrumenteve tatimore të rëndësishme ose e kontrollit ndaj një pjese të shpenzimeve publike e kufizon aftësinë e pushtetit qendror për të manevruar me tatimet ose zvogëlimin e shpenzimeve për t'iu përgjigjur kërkesave vendore gjithnjë në rritje. Minimizimi i koston makroekonomike të decentralizimit kërkon që pushteti qendror të zhvillojë dialog aktiv me pushtetin lokal dhe ta inkuadroj atë në përpjekjet për rregullimin e menaxhimit makroekonomik.

Decentralizimi duhet të zhvillohet në harmoni me potencialin dhe preferencat ekonomike të vendit, në mënyrë që të mos e ngarkojë tatimpaguesin me tatime të reja. Poashtu pushtetet lokale kanë nevojë që të jenë të kontrolluara sa i përket ndërtimit dhe ekzekutimit të politikave të të hyrave dhe konsumit buxhetor.

III. ZHVILLIMI EKONOMIK

3.1. Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal dhe infrastruktura

Një ndër fushat me të cilat ngarkohen komunat me Rregulloren 2000/45 është edhe ajo që ato janë përgjegjëse për krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillim ekonomik lokal. Në këtë aspekt shumë komuna Kosovare kanë përpiluar strategjitë e tyre të zhvillimit ekonomik lokal e sidomos në këtë drejtim prijnë shtatë komunat - pjesëmarrëse në projektin DELTA. Në procesin e hartimit të strategjisë janë edhe disa komuna, të cilat nuk kanë marrur pjesë në këtë projekt, si për shembull komuna e Prishtinës, e cila ka angazhuar në një projekt një konzorcium Gjerman, i cili do të trajtojë drejtoratin e Komunës për Urbanizëm në hartimin e strategjisë zhvillimore të qytetit. Poashtu, edhe komuna e Shtimes gjendet në procesin e hartimit të strategjisë së saj, e cila ka angazhuar një numër institucionesh vendore dhe ndërkombëtare për të dalur me strategjinë zhvillimore të kësaj komune. Komunat, të cilat i kanë përpiluar strategjitë e tyre gjenden në fazën e implementimit të tyre. Një numër i madh i komunave kanë realizuar projekte kapitale në infrastrukturë si në ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve, ujësjellësve, kanalizmit, ndërtimin e shkollave, spitaleve, etj. Shumë nga këto projekte janë kryer me pjesëmarrjen nga buxheti komunal, pjesëmarrjen e komunitetit, si dhe me kontributin e çmueshëm nga donatorët e jashtëm. Këto projekte të realizuara me siguri se do të ndikojnë edhe më tej në mbështetjen zhvillimit ekonomik lokal si dhe në mbështetjen dhënë iniciativës private të biznesit. Në vijim po japim edhe investimet e donatorëve gjatë viteve 1999-2003 në Kosovë, në fushat, të cilat kanë efekte direkte në zhvillimin ekonomik lokal.

3.1.1 Kontributi i donatorëve sipas viteve 1999-2003

Tabela 1. Kontributi i donatorëve me ndikim direkt në zhvillim ekonomik lokal

Viti	Sektori	Të Shpenzuara (000)
1999	Bujqësi	€125.05
1999	Qeverisje Demokratike dhe Shoqëri Civile	€974.65
1999	Arsimim dhe Shkencë	€5,632.38
1999	Ambient	€85.17
1999	Shëndetësi	€1,336.39
1999	Banim	€26,894.52
1999	Punësim	€114.75
1999	Administratë Lokale	€166.04
1999	Postë dhe Telekomunikime	€27.54
1999	Shërbime të Ndërmarrjeve Publike	€15,834.25
1999	Mirëqenie Sociale	€36,032.50

1999	Transport dhe Infrastrukturë	€174.16
1999 Total		€87,397.41
2000	Bujqësi	€13,634.45
2000	Qeverisje Demokratike dhe Shoqëri Civile	€9,491.54
2000	Arsimim dhe Shkencë	€40,575.90
2000	Ambient	€184.64
2000	Shëndetësi	€19,975.59
2000	Banim	€155,530.66
2000	Punësim	€1,081.20
2000	Administratë Lokale	€6,727.14
2000	Postë dhe Telekomunikime	€2,480.81
2000	Shërbime Publike	€9,748.34
2000	Shërbime të Ndërmarrjeve Publike	€124,487.13
2000	Mirëqenie Sociale	€8,093.19
2000	Transport dhe Infrastrukturë	€47,057.22
2000 Total		€439,067.81
2001	Bujqësi	€20,134.30
2001	Qeverisje Demokratike dhe Shoqëri Civile	€20,815.94
2001	Arsimim dhe Shkencë	€26,626.86
2001	Ambient	€553.12
2001	Shëndetësi	€24,301.98
2001	Banim	€90,831.68
2001	Punësim	€6,928.34
2001	Administratë Lokale	€12,255.75
2001	Postë dhe Telekomunikime	€5,280.42
2001	Shërbime Publike	€6,599.13
2001	Shërbime të Ndërmarrjeve Publike	€190,669.88
2001	Mirëqenie Sociale	€2,534.03
2001	Transport dhe Infrastrukturë	€39,275.12
2001 Total		€446,806.53
2002	Bujqësi	€12,670.44
2002	Qeverisje Demokratike dhe Shoqëri Civile	€33,152.96
2002	Arsimim dhe Shkencë	€22,733.54
2002	Ambient	€1,077.78
2002	Shëndetësi	€16,250.22
2002	Banim	€67,572.85
2002	Punësim	€4,012.49
2002	Administratë Lokale	€9,606.10
2002	Postë dhe Telekomunikime	€14.74
2002	Shërbime Publike	€3,539.28
2002	Shërbime të Ndërmarrjeve Publike	€91,175.37
2002	Mirëqenie Sociale	€3,962.62
2002	Transport dhe Infrastrukturë	€17,830.32
2002 Total		€283,598.70
2003	Bujqësi	€8,043.55
2003	Qeverisje Demokratike dhe Shoqëri Civile	€6,875.63
2003	Arsimim dhe Shkencë	€3,552.65

2003	Ambient	€159.58
2003	Shëndetësi	€11,284.49
2003	Banim	€3,748.55
2003	Punësim	€1,811.68
2003	Administratë Lokale	€4,795.15
2003	Shërbime Publike	€3,072.05
2003	Shërbime të Ndërmarrjeve Publike	€45,195.97
2003	Mirëqenie Sociale	€248.25
2003	Transport dhe Infrastrukturë	€2,399.59
2003 Total		€91,187.16
2004	Bujqësi	€126.80
2004	Shërbime Publike	€86.89
2004	Shërbime të Ndërmarrjeve Publike	€165.39
2004 Total		€379.08
Grand Total		€1,348,436.69

Burimi: RIMS database: 009/12/2003

Vërejtje: Tabela përfshin vetëm kontributet e donatorëve, në fushat, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal.

Nga Tabela 1 mund të shihet kontributi i donatorëve gjatë viteve 1999-2003. Donatorët më të mëdhenjë janë: SHBA-të, shtetet e Bashkimit Europian, Japonia, Kanadaja, Zvicra, shtetet Skandinave, Emiratet e Bashkuara Arabe, Banka Botërore, UNDP, Agjencia Europiane për Rindërtim, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe shumë shtete tjera dhe organizata ndërkombëtare qeveritare dhe jo-qeveritare. Nga tabela mund të shihet se donacionet kanë pësuar një rënie të vazhdueshme prej vitit 2000 e deri më 2003. Gjithashtu, ky trend pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2004. Megjithë investimet e mëdha që janë bërë në Kosovë pas luftës, në shumë segmente, e sidomos në infrastrukturë dhe në shumë projekte kapitale në Kosovë, nga anketimi² i 607 bizneseve private në Kosovë del se ndërmarrjet akoma ankohen për infrastrukturën e pazhvilluar si një ndër shkaqet e pengesave për zhvillimin e projekteve të reja, dhe tërheqjen e investimeve të brendshme dhe të jashtme.

3.2. Rrethina ekonomike

Edhe pse komunat sipas Rregullorës 2000/45 kanë të drejtë dhe obligim për zhvillimin ekonomik lokal, ato pak mund t'u ofrojnë bizneseve. Qëndrimi i përfaqësuesve të komunave të Kosovës është se ata po bëjnë ç'është e mundur për krijimin e një ambienti favorizues për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, por se roli i tyre në funksion të këtij zhvillimi është mjaft i kufizuar dhe se brengë e tyre e madhe është mungesa e kompetencave. Edhe qytetarët e anketuar³ i fajësojnë thuajse shumë pak qeveritë lokale për problemet e tyre ekonomike. Vetëm 4.2% e tyre mendon se ata janë përgjegjës,

² Riinvest (2002): Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë, Raporti Vjetor 2002, Prishtinë.

³ Riinvest, anketa me familje lidhur me Paralajmërimin e Hershëm, dhjetor 2003

kundrejt 62% e të cilëve që për këtë e bënë përgjegjës UNMIK-un dhe 21.5% e bënë përgjegjës Qeverinë e Kosovës. Problem në vete paraqet pamundësia e komunave për të menaxhuar me pronën komunale, centralizimi i regjistrimit të bizneseve, etj. Nga anketimi i NVM-ve në Kosovë del se konkurrenca lolojale, mungesa e ligjeve, konkurrenca e ashpër, tatimet e larta, si dhe problemet e qasjes në kredi janë pengesat themelore në afarizmin e NVM-ve.

3.3. Politika për nxitjen e investimeve

Edhe pse politikat e veçanta për nxitjen e investimeve vendase, por edhe atyre të huaja, i takojnë nivelit qendror (taksat, tatimet, doganat), komunat po mundohen të zhvillojnë procedurara sa më të thjeshta në mënyrë që sadopak t'i mbështesin bizneset. Sipas zyrëtarëve komunal, si politika nxitëse janë duke u përdorur dhënia e objekteve pa pagesë bizneseve, ndarja e parcelave falas atyre prodhuese e madje edhe pjesëmarrja direkte e komunave në investime të ndërmarrjeve private, favorizimi i bizneseve prodhuese në politikën e ngarkesave fiskale si dhe krijimi i zonave industriale dhe atyre tregtare. Megjithë këto favore që pushtetet komunale janë duke iu ofruar bizneseve, problem në vete paraqet politika e sotme fiskale në nivel qendror. Kjo politikë fiskale nuk është e orientuar në nxitjen e investimeve dhe të zhvillimit ekonomik. Sa i përket investimeve të huaja, pengesë në vete paraqet edhe vonesa në zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, ku investitorët e huaj ndihen të pasigurtë për të investuar në Kosovë.

3.5. Partneriteti në zhvillimin ekonomik lokal - përvojat nga Projekti DELTA

Pushteti lokal ka filluar të rrisë nivelin aktivitetit të tij për krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e bizneseve. Udhëheqësitë komunal po synojnë thjeshtësimin e procedurave për marrjen e lejeve për fillimin e bizneseve të reja, ndërtimin e infrastrukturës komunale, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, dhe aplikimin e ngarkesave fiskale që janë të përballueshme për bizneset. Rezultate të theksuara në krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e bizneseve kanë arritë komunat e përfshira në Projektin DELTA. Komunat e përfshira në fazën e parë të këtij projekti janë: Prizreni, Kaçaniku, Vitia, Podujeva, Vushtrria, Klina dhe Istogu.

Projekti DELTA është një iniciativë e përbashkët e Grupit të Bankës Botërore, Qeverisë Komunale dhe Iniciativës për Reformë të Shërbimeve Publike (IAL), që është i përfshirë në rrjetin e programeve të Institutit për Shoqëri të Hapur (OSI). Hartimi i strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal të komunave (ZHEL) është pjesë përbërëse e projektit DELTA, i cili është udhëhequr nga ekspertë të Zhvillimit Ekonomik Lokal të Bankës Botërore dhe të OSI dhe është implementuar në nivel lokal nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore (Riinvest).

Struktura e Projekteve në kuadër të Strategjive të ZHELit

- Gjithsej projekte 187
- Infrastrukturë institucionale (e butë) 76 projekte
- Infrastrukturë publike (e fortë), siç janë zonat industriale, ndërtimi i rrugëve, ujësjellsve, etj.- 111 projekte

Projekti synon mbështetjen e komunave Kosovare për krijimin e kapaciteteve të tyre për të hartuar dhe implementuar strategjitë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL) që do të krijojë një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e NVM-ve dhe do të forcojë lidhjet mes qeverive lokale dhe organizatave tjera (shoqatave afariste, shoqatave profesionale, OJQ-ve të përfshira nën zhvillimin ekonomik lokal).

Gjatë zhvillimit të këtij projekti të gjitha komunat e përfshira në projekt (Prizreni, Klina, Istogu, Podujeva, Vushtrria) i kanë hartuar strategjitë e tyre të zhvillimit ekonomik dhe i

Struktura e burimeve të financimit të projekteve të ZHELit

- Nga buxheti i komunave (vetëm) 38 projekte (20.3%)
- Të përbashkëta 125 projekte (66.8%)
- Në partneritet me komunitetin e biznesit 9 projekte (4.8%)
- Nga buxheti qendror 7 projekte (3.7%)
- Nga komuniteti i biznesit 4 projekte (2.2%)
- Nga donatorët 2 projekte (1.1%)
- Komuniteti 2 projekte (1.1%)

kanë aprovuar në kuvendet komunale. Ka filluar realizimi i një numri të projekteve. Prej gjithsej 187 projekteve sa janë të përfshira në strategjitë zhvillimore të këtyre komunave, 125 prej tyre parashihet që të realizohen me investime të përbashkëta të komunave me komunitetin e biznesit, donatorët, pushtetin qendror dhe komunitetet. Të dhënat e më sipërme dëshmojnë për rezultate konkrete në ndërtimin e partneriteteve ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, ndërmjet sektorit publik dhe donatorëve dhe institucioneve financiare.

Rezultatet e arritura

- Aftësimi i zyrtarëve komunalë për hartimin e strategjive, hartimin e projekteve dhe realizimin e tyre;
- Krijimi i kanaleve të komunikimit dhe ndërtimi partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal dhe komunitetit të biznesit, pushtetit lokal dhe donatorëve
- Sensibilizimi i zyrtarëve komunalë për nevojat dhe brengat e komunitetit të biznesit
- Krijimi i një ambienti miqësor për zhvillimin e NVMve
- Nxitja e interesimit edhe të komunave tjera për hartimin e strategjive të tyre të zhvillimit

Në kuadër të strategjive zhvillimore të komunave janë të përfshira edhe 111 projekte për ndërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës publike komunale, siç është ndërtimi i zonave industriale, ndërtimi i rrugëve, ujësjellësve. Pritet se me përmirësimin e infrastrukturës publike do të zvogëlohet kostoja e investimeve ngase vlerësohet se për

shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate publike, investimet në Kosovë kanë kosto më të lartë për rreth 15% në krahasim me vendet tjera të regjionit.

Pritet që Projekti DELTA II të fillojë në Janar të vitit 2004. Në këtë projekt do të përfitojnë 5 komuna. Interesimi i komunave për pjesëmarrje në këtë projekt është shumë i madh.

V. POLITIKA TATIMORE

5.1. Burimet e të hyrave komunale

Me Rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave 2000/45 kuvendet komunale autorizohen që të nxjerrin buxhetin komunal i cili duhet të përmbajë planin për aktivitete dhe menaxhim ekonomik brenda vitit fiskal, duke përfshirë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe të përgjithshme të komunës. Në anën tjetër Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike parasheh që komunat të kenë pushtet mbi proceset buxhetore në Komunë nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv Financiar, Departamentit të Thesarit dhe Departamentit të Buxhetit sipas ecurive dhe procedurave analoge me ato që vlejnë për nivelin qendror. Adoptimi i standardeve unike të evidencës kontabël, të raportimit dhe të llogaridhënjes, mundësojnë që menaxhimi i buxheteve komunale të jetë më i efektshëm dhe më transparent. Kontribut të rendësishëm në këtë drejtim po jep edhe përfshirja e komunave në projektin e Free Balancit. Në këtë kontekst e theksojmë se deri më tani 24 komuna kosovare janë certifikuar për manaxhimin me tarifa dh engarkesa, kurse 29 komuna janë certifikuar për manaxhim të financave.

Kryesisht janë dy burime për formimin e buxheteve komunale: granti që vjen nga buxheti i Kosovës dhe, të hyrat vetanake. Deri në shtator të vitit 2003 të hyrat vetanake të komunave ishin nën nivelin e parashikuar. Nga 27.8 milion të parashikuara, komunat realizuan 16.32, ose 58.7% të tyre. Në të njejtën kohë komunat shpenzuan 56.2% nga mjetet e planifikuara (duke përfshirë edhe grantet nga buxheti qendror). Të hyrat vetanake të komunave në vitin 2002 në krahasim me vitin 2001 u rritën për 11%, kurse në vitin 2003 llogariten se do të jenë rreth 36% më të larta nga një vit më parë. Në vitin 2004 pritet se komunat nga të hyrat vetanake do të grumbullojnë rreth 34 milion euro, që shënon rritje prej rreth 23% në krahasim me vlerësimet për këtë vit. Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme të komunave në vitin 2001 ishte 40%, në vitin 2002 18.5%, në vitin 2003 19.5% dhe në vitin 2004 pritet të jetë rreth 16.8%. Me projeksionin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2004 parashihen 154.8 milion, apo 25% e e këtij buxheti të orientohet për buxhetet komunale. Një pjesë e këtyre granteve, për herë të parë, është strukturuar drejtpërdrejtë për t'u ndihmuar komunave të Kosovës në zhvillimin e burimeve të tyre të të hyrave. Kështu një pjesë e grantit të përgjithshëm është strukturuar si stimulim për të shpejtuar zhvillimin e tatimit komunal në pronë. Secila komunë do të marrë €1,000 në grantin bashkërendues, për çdo €1,000 që ajo grumbullon nga tatimi në pronë, deri në planin e llogaritur për secilën komunë.

	2001	2002	2003
Grantet speciale	0	60.6	81.77
Arsimi		42.9	63.33
Shëndetësia		17.7	18.44
Përqindja nga të ardhurat e		56.7%	49.5%
Grantet e përgjithshme	14.1	26.5	55.4
Përqindja nga të ardhurat e	59.5%	24.8%	33.7%
Të hyrat vetanake	9.6	19.6	27.8
Përqindja nga të ardhurat	40.5%	18.4%	16.8%
Të hyrat e përgjithshme	23.7	106.8	164.97

Burimi: MEF

Të hyrat e veta komunitat i realizojnë kryesisht nga këto burime:

- Tatimi në pasuri,
- Taksat administrative nga dhënia e licencave dhe pagesave të tjera që i cakton komuna,
- Të hyrat nga asetet e komunave
- Gjjobat apo përqindja nga inkasimi i gjobave.

4.2. Llojet e tatimeve dhe taksave komunale dhe përmirësimi i sistemit të grumbullimit të tyre

Rreth 50% e bizneseve të anketuara vlerësojnë se janë "pak" të informuar lidhur me formimin e buxhetit, kurse rreth 41% nuk janë "aspak" të informuar. Ndërkaq, sipas të anketuarve, si masa për rritjen e efikasitetit fiskal vlerësohen: ulja e normave tatimore, mbulimi i pikave kufitare, forcimi i administratës tatimore,

Në komunat të cilat janë vizituar (Prishtina, Gjiłani, Shtimja dhe Malisheva) vlerësojnë se në përgjithësi inkasimi dhe menaxhimi i tatimit në pronë nuk është në nivelin e dëshirueshëm. Për shembull, në komunën e Malishevës tatimi në pronë është realizuar 40.42%, kurse në komunën e Shtimes është realizuar 32.86%. Përgjithësisht në realizimin e dobët të këtij tatimi bënë komuna e Prishtinës, ku ai është realizuar mbi 114 %. Por, sipas zyrtarëve të Drejtoratit për Financa të komunës së Prishtinës, kjo ndodhur për shkak të aplikimit të këtij lloji tatimi për së pari herë në komunë (projekti pilot), dhe për shkak të faktit se me këtë rast është nënçmuar kapaciteti realizues i këtij tatimi. Megjithatë vështirësitë në realizimin e tatimit në pronë, zyrtarët komunalë të intervistuar thonë se ai është në përmirësim e sipër. Niveli i arkëtimit të këtij tatimi është shtuar sidomos në komunat në të cilat në ndërkohë janë marrë masa për uljen e normës së këtij tatimi, siç është rasti me komunën e Prishtinës. Si mënyrë e efektshme e presionit qytetarëve për të paguar tatimin në pronë është treguar në disa komuna kushtëzimi i dhënies së dokumenteve qytetarëve me pagesën e tatimit në pronë. Mirëpo mund të konstatohet se në përgjithësi akoma ndihet mungesa e mekanizmave për inkasim, prandaj arkëtimi i këtij tatimi mbetet të jetë modest. Është e njohur se edhe përvojat në vendet e tjera në tranzicion nuk janë shumë kurajuese se ky burim i të hyrave mund t'i përmbush pritjet për një kohë të shkurtër. Problem të veçantë paraqet inkasimi i tatimit në pronë në pjesën veriore të Mitrovicës si dhe në enklavat Sërbe.

Në tabelat e mëposhtme mund të shihet struktura e pjesëmarrjes së burimeve të të hyrave komunale në buxhetet vetanake të tri komunave Kosovare: Malisheva, Prishtina, dhe Shtimeja.

Tabela 1: Struktura e buxhetit të komunës së Malishevës sipas të hyrave vetanake të realizuara deri më 11.12.2003

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Pjesëmarrja %
1	Të hyrat nga regjistrimet e bizneseve të reja	0.31
2	Të hyrat nga tarifat administrative	13.28
3	Të hyrat nga tenderët	1.80
4	Të hyrat nga Pishina	4.25
5	Të hyrat nga tarifat dhe ngarkesat tatimore (taksat komunale)	19.88
6	Te hyrat nga dënimet në komunikacion	20.50
7	Të hyrat nga gjobat dhe ndëshkimet	0.32
8	Të hyrat nga gjeodezia	5.78
9	Të hyrt nga qiraja	0.24
10	Të hyrat nga urbanizmi	7.69
11	Të hyrat nga tatimi në pronë	18.16
12	Të hyrat nga ndërrimi i destinacionit të tokës	2.21
13	Të hyrat nga tregjet	3.25
14	Të hyrat tjera	2.31

Burimi: Drejtorati për Ekonomi dhe Financa i komunës së Malishevës – dt. 12.12.2003

Në komunën e Malishevës tatimi në pronë është realizuar 40.42% (nga €61,270 të planifikuara janë realizuar €151,589), kurse buxheti total i planifikuar i të hyrave komunale vetanake është realizuar 76.59% (nga €440,405 të planifikuara janë realizuar €337,328).

Tabela 2: Struktura e buxhetit të komunës së Prishtinës sipas të hyrave vetanake të realizuara deri më 11.12.2003

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Pjesëmarrja %
1	Të hyrat nga trafiku	14.71
2	Te hyrat administrative	3.68
3	Të hyrat nga kadastri	5.64
4	Të hyrat nga inspekcioni	3.43
5	Të hyrat na renta	3.55
6	Të hyrta nga transformimi në pronë	17.19
7	Të hyrat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike	9.80
8	Licencat në biznes	17.16
9	Panot reklamuese	2.0
10	Tatimi në pronë	19.19

11	Leja e ndërtimit	17.16
----	------------------	-------

Burimi: Drejtorati për Financa i komunës së Prishtinës – dt. 12.12.2003

Në komunën e Prishtinës tatimi në pronë është realizuar mbi 114 % (nga € 700,000 të planifikuara janë realizuar mbi € 800,000).

Tabela 3: Struktura e buxhetit të komunës së Shtimjes sipas të hyrave vetanake të realizuara gjatë periudhës 01.01.2003 – 30.11.2003

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Pjesëmarrja %
1	Leja për ndërtim dhe konstruktim	9.44
2	Ndërrimi i destinimit të tokës	5.04
3	Analizimi i dimensioneve të pronës	8.95
4	Hapësira për tregje dhe objekte tjera	4.40
5	Objektet komunale me qira	7.18
6	Trafiku	9.31
7	Regjistrimi pronës dhe transferi	6.44
8	Çertifikatat e lindjes dhe vdekjes	10.20
9	Kopjet e çertifikatave	0.46
10	Tatimi në pronë	8.35
11	Taksat administrative	8.21
12	Licencimi i biznesit	0.86
13	Pagesat tjera	21.13
14	Gjobat tjera	0.01

Burimi: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa e komunës së Shtimes – dt. 15.12.2003

Në komunën e Shtimes tatimi në pronë është realizuar 32.86% (nga €39,000 të planifikuara janë realizuar €12,815). Kurse, sa i përket realizimit të buxhetit të planifikuar nga të hyrat vetanake, nga €237,750 sa janë planifikuar, janë realizuar 64.56% ose €153,474.

VI. SHËRBIMET PUBLIKE

6.1. Menaxhimi i shërbimeve të ndërmarrjeve publike komunale dhe cilësia e tyre

Sot ndërmarrjet komunale publike në Kosovë janë të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e cila, duke filluar nga tetori i këtij viti, e ka bërë regjionalizimin e tyre, ku 37 ndërmarrje të mëdha publike janë riorganizuar në 6 ndërmarrje regjionale, të cilat menaxhohen në mënyrë të centralizuar nga AKM, kurse komunat kanë përfaqësuesin e tyre në bordin mbikëqyrës. Rregullorja 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave ua rezervon të drejtën komunave për ofrimin e shërbimeve publike komunale si uji, kanalizimi, pastrimi, etj.. Ndërkaq, sipas Rregullores 2000/49 mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Shërbimeve Komunale Publike, komunat nuk kanë kompetenca në strukturat udhëheqëse të ndërmarrjeve publike komunale. Ndërkaq,

AKMja si menaxhuese e tyre, meqë nuk është afër qytetarëve nuk i njih problemet e qytetarëve, prandaj edhe nuk mund të ofrojë shërbime të mira.

Sipas hulumtimit të bërë nga Instituti Riinvest⁴, në përgjithësi qytetarët nuk janë aq të kënaqur me shërbimet e ofruara komunale. Si arsye e pakënaqësisë lidhur me shërbimet administrative më së shumti paraqitet organizimi i dobët i shërbimeve (16%). Arsyet tjera janë edhe aftësitë jo të mjaftueshme profesionale të zyrtarëve komunalë dhe sjellja joadekuate e tyre me palët. Por, edhe sa i përket higjienës publike, 52% e respondentëve janë të pakënaqur, kurse 43% e respondentëve shprehen të kënaqur me shërbimet e ofruara. Pakënaqësitë e qytetarëve shprehen edhe në lidhje me infrastrukturën rrugore lokale, ku vetëm 31% e respondentëve shprehen të kënaqur, kundrejt 67% të respondentëve të pakënaqur.

Duke i patur parasysh këto elemente, do të ishte e udhës që të bëhet një riorganizim i ofrimit dhe mbikqyrjes së shërbimeve publike në Kosovë. Me qëllim që shërbimi të jetë sa më afër qytetarit dhe në mënyrë që funksionimi i tyre të jetë sa më efektiv është e rrugës që ato ndërmarrje - ofruese të shërbimeve publike që zhvillojnë aktivitetin e tyre nëpër tërë territorin e Kosovës të menaxhohen nga pushteti qendror siç është rasti me energjinë elektrike, post-telekomunikacionin, etj. Kurse, ndërmarrjet që ofrojnë shërbime vetëm në nivelin komunal të menaxhohen nga pushteti komunal.

6.2. Konkurrenca private në shërbimet publike

Komunat janë për lejitimin e konkurrencës private në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve, edhe pse akoma nuk ka lëvizje të duhura në këtë drejtim. Hapja e tregut të shërbimeve publike në nivel lokal, por edhe në atë qendror ndaj konkurrencës do të ndikonte në uljen e çmimeve dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore qytetarëve. Megjithatë, tregu i ka dështimet e veta dhe me futjen e konkurrencës në ofrimin e shërbimeve publike, pushteti lokal duhet të adoptojë edhe një numër të rregulloreve të cilat do të mbronin konsumatorët, siç janë normat maksimale të pagesës së atyre shërbimeve, standardet për cilësi dhe siguri, etj.. Me këtë rast do të ishte me interes për t'u përmendur ideja për mirëmbajtjen e banesave në komunën e Gjilanit. Banorët e banesave në Gjilan kanë filluar ta paguajnë kontributin për mirëmbajtjen e banesave. Me këtë rast, banorët ia paguajnë kontributin komunave, kurse komuna angazhon kompani private që të bëjnë pastrimin, lysterjen dhe meremetimin e banesave.

Rekomandimet

Zhvillimi aktual ekonomik lokal kërkon qartësimin dhe definimin më të përafërt të fushëveprimit dhe përgjegjësisë të pushtetit lokal, shtimin e vazhdueshëm të efikasitetit

⁴ Riinvest (2003): Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm, Prishtinë, 2003.

të këtij pushteti në shumë fusha dhe ofrimin më të shpejtë dhe më cilësor të shërbimeve. Në funksion të kësaj prezentojmë këto

Rekomandime

- 1. Të bëhet qartësimi më i përafërt i kompetencave midis pushtetit qendror, UNMIKut dhe AKMsë;**
- 2. Të vazhdojë ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të shërbimeve komunale për plotësimin më të mirë të kërkesave të qytetarëve;**
- 3. Zhvillimi i aktiviteteve dhe debateve profesionale për bartjen e shërbimeve më afër qytetarëve përmes decentralizimit të pushteti lokal mbi bazat e efikasitetit dhe racionalitetit;**
- 4. Ngritja e efikasitetit të shërbimeve publike përmes hapjes së tregut dhe konkurrencës së sektorit privat dhe rregullimit të standardeve të sigurisë dhe kontrollit të çmimeve me qëllim të mbrojtjes së standardit të qytetarëve;**
- 5. Shtimi i efikasitetit në menaxhimin e buxheteve komunale përmes ngritjes së nivelit të arkëtimit të tatimeve, sidomos atij në pronë, dhe racionalitetit të shpenzimeve publike;**
- 6. Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të administratës lokale me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore bizneseve;**
- 7. Ndërtimi i infrastrukturës së domosdoshme dhe sigurimi i zonave ekonomike të cilat do të nxitnin investimet vendore ekonomike dhe do të tërhiqnin investitorët e jashtëm.**